

P. nr. 310/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit M. R. Gjakova, për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP.nr.39/16 të dt. 27.05.2016, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë 31.10.2016, në prani të Prokurorit së shtetit Ramiz Buzhala dhe të akuzuarës, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **M. R.**, i lindur me dt. ..., i biri M. dhe i A. e gjinisë H., ka të kryer shkollën fillore, roje, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar at i 2 fëmijëve.

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

- me dt. 18.11.2015, në Gjakovë, në rrugën "N.Tereze", është rikyqur në mënyrë të paautorizuar në rrjetin elektrik, pasi që me pare me dt. 03.11.2015, nga zyrtaret e KEDS-it Distriki në Gjakovë është ç'kyçur për borxhin e pa paguar për energjinë elektrike të shpenzuar në lartësi prej 331.69 euro, gjendje kjo e konstatua nga personat e autorizuar të dëmtuarës KEDS Distrikti në Gjakovë .

-me çka ka kryer veprën penale lidhja e paautorizuar në shërbimeve nga neni 321 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4,17,41,46,49,50,51,52 par.5, 73 ,neni 321 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarës i shqipton :

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, si dhe dënimin me gjobë në shume prej 100 (njëqind) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20,00 €, në afat prej 15 ditëve, pasi që Aktgjykimi të marrë formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr. 39/16 të dt.27.05.2016, e ka akuzuar të akuzuarin M. R. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala, në shqyrtimin gjyqësor me dt.31.10.2016, ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.39/16, dt.27.05.2016 kundër të akuzuarit M. R.

I akuzuari M. R., në shqyrtimin gjyqësor thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimin të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe

pa presion, shtoj se kjo gjendje është konstatuar nga ana e KEDS-it, pamundësi që ta paguaj shumën e tërësishme të borxhit prej 331.69 euro, për shkak të kushteve ekonomike unë jam rikyçur, por tani nga ana e të dëmtuarës me është mundësuar pagesa me këste këtij borxhi ku krahas borxhit e paguaj edhe këstin në shumë prej 32 euro, andaj gjykatës i propozojë që të marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, gjendjen e varfër ekonomike, jam i vetmi anëtar që sigurojë të ardhura në shumë prej 120 euro, me qenë se jam invalid në dorën e djathtë, si dhe faktin se është hera e parë që bie në ndesh me ligjin të me shqiptojë një dënim me të butë.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari M. R., me dt. 18.11.2015, në Gjakovë, në rrugën “N.Tereze” ,është rikyçur në mënyrë të paautorizuar në rrjetin elektrik, pasi që me parë me dt. 03.11.2015, nga zyrtaret e KEDS-it Distriku në Gjakovë është ç’kyçur për borxhin e pa paguar për energjinë elektrike të shpenzuar në lartësi prej 331.69 euro, gjendje kjo e konstatua nga personat e autorizuar të dëmtuarës KEDS Distriku në Gjakovë.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga e akuzuara e cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga e akuzuara është bere në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bere vullnetarisht nga e akuzuara, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarës formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarën ta shpallë fajtorë dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, me parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të saj.

Me rastin e matjes së dënimit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh, pranimin e vullnetshëm të fajësisë, karakteristikat personale të akuzuarit si invalid, i gjendjes së varfër ekonomike, i vetmi anëtar i familjes që siguron të ardhura mujore prej 120 euro, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej veprë penale si dhe faktin që është hera e parë që bie në ndesh me ligjin të cilat rrethana ndikuan që Gjykata të zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 75 të KPRK-së, Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me kusht në kohëzgjatje prej 2(dy) muajve, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 100 (njëqind) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 dhe 50 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P. nr.310/16 më datë 31.10.2016.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej 15 ditësh ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.